

SKEDA INFORMUESE

Mundësi për aplikim të Bashkive në dy çmimet “The European Capital of Innovation (iCapital)” dhe “The European Rising Innovative City”

Synimi i thirrjes për dy çmimet:

Kjo thirrje për çmimet për bashkitë “The European Capital of Innovation (iCapital)” dhe “The European Rising Innovative City” synon të njohë dhe shpërblejë bashkitë që kanë krijuar mjedise inovatore, të cilat mbështesin rritjen e startup-eve dhe ndërmarrjeve të vogla e të mesme (NVM-ve), përshpejtojnë ekosistemin lokal të inovacionit dhe përfshijnë qytetarët në praktika demokratike dhe zhvillimore. Thirrja vlerëson ato bashki që janë shndërruar në qendra për zgjidhje të reja ndaj sfidave shoqërore dhe klimatike, duke përfshirë një sërë aktorësh lokalë.

Tematikat:

- Risi në qeverisje dhe përfshirje qytetare
- Ekosisteme të forta të inovacionit lokal
- Transformim dixhital dhe tranzicion i gjelbër
- Nxitje e rritjes së ndërmarrjeve inovative
- Zgjidhje për sfida si ndryshimet klimatike, kohezioni social, rritja e qëndrueshme

Rezultatet e pritshme:

- Shpërblimi financiar për bashkitë fituese
- Rritje e dukshmërisë në nivel europian
- Përfshirje në rrjetin “iCapital Alumni Network” për shkëmbim praktikash
- Forcim i imazhit dhe tërheqja e investimeve, talenteve dhe partneriteteve
- Rritje e kapaciteteve për të udhëhequr në fushën e inovacionit urban

Kush mund të aplikojë:

Në 2 thirrjet për çmime mund të aplikojnë vetëm **bashkitë**. Nuk pranohen aplikime në grup. Bashkitë duhet të jenë me më shumë se 50.000 banorë.

1. Kategoria “European Capital of Innovation” për bashki me ≥ 250.000 banorë. Në shtetet ku s’ka bashki me kaq popullsi, pranohen edhe bashki me mbi 50.000.

2. Kategoria “European Rising Innovative City” për bashki me 50.000 – 249.999 banorë.

Bashkitë duhet të jenë në një Shtet Anëtar të BE-së ose vend i Asociuar në Horizon Europe. Shqipëria është vend i Asociuar në Horizon Europe prandaj Bashkitë shqiptare janë të pranueshme të marrin pjesë në këto 2 çmime.

Fituesit e mëparshëm (dhe vendet e 2-ta të vitit 2024) nuk janë të pranueshëm.

Kriteret për të qenë fituese bashkitë duhet të kenë kryer këtë procese:

1. Eksperimentim – koncepte, procese, mjete dhe modele qeverisjeje inovative që vërtetojnë angazhimin e bashkisë për të vepruar si një platformë mundësuese për integrimin e praktikave inovative në procesin e zhvillimit urban.

2. **Përshkallëzim** – promovimi i aktorëve të ndryshëm të ekosistemit lokal të inovacionit, mbështetja e rritjes së startup-eve dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme inovative, krijimi i një kuadri ligjor miqësor ndaj inovacionit, krijimi i një mjedisi që stimulon rritjen dhe tërheq investime private dhe publike, burime, diversitet dhe talente, si dhe nxitja e inovacionit përmes prokurimit publik efikas.
3. **Ndërtimin e ekosistemit** – krijimi i bashkive si lehtësues të ekosistemit lokal të inovacionit duke nxitur bashkëpunimin midis aktorëve të ndryshëm si bizneset, startup-et, shoqëria civile, qytetarët dhe universitetet.
4. **Zgjerimin** – veprimi si një model për bashkitë e tjera për të mbështetur përhapjen dhe replikimin e zgjidhjeve të testuara që nxisin krijimin e ekosistemit lokal të inovacionit, transferimin e njohurive dhe ndërtimin e kapaciteteve.
5. **Vizionin inovativ të qytetit** – bashkitë aplikuese duhet të tregojnë vizionin/planin e tyre strategjik afatgjatë, duke theksuar iniciativat inovative që kanë kontribuar pozitivisht në transformimin e qytetit dhe të cilat do të mbështesin më tej zhvillimin e një ekosistemi inovacioni të qëndrueshëm dhe që i përshtatet tranzicionit të gjelbër dhe dixhital.
6. **Të drejtat e qytetarëve** – përdorimin e inovacionit për të forcuar demokracinë, për të mbrojtur të drejtat e qytetarëve, për të nxitur kohezionin social dhe për të siguruar integrimin e grupeve vulnerabël të pakicave, gjinisë, aftësive të kufizuara ose racës.

Vlerësimi:

- Pikët maksimale: **60 pikë**.
- Pragu për t'u kaluar: **6/10 pikë**.
- Pragu i përgjithshëm për secilën pikë: **36 pikë**.

Llojet e çmimeve:

1. **European Capital of Innovation:**
 - a) Çmimi për vendin e parë: 1,000,000 EUR
 - b) Dy vendet e dyta: 100,000 EUR secila
2. **European Rising Innovative City:**
 - a) Çmimi për vendin e parë: 500,000 EUR
 - b) Dy vendet e dyta: 50,000 EUR secila

Si bëhet aplikimi:

Aplikimi është i njëjtë për 2 çmimet dhe bëhet online përmes portalit të Komisionit Evropian Funding & Tenders Portal.

- Pjesa A (online) – të dhëna administrative
- Pjesa B (upload PDF) – përshkrimi teknik i aplikimit
- Letër mbështetjeje e firmosur nga Kryetari i Bashkisë (max 2 faqe)

Limiti: max 30 faqe për pjesën B

Kur është afati i fundit:

Afati i fundit për të dërguar aplikimet: **18 Qershor 2025, ora 17:00 CET (ora e Brukselit)**

Linku i thirrjeve të 2 çmimeve:

Thirrja “European Capital of Innovation”: <https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/opportunities/topic-details/HORIZON-EIC-2025-PRIZE-2-01>

Thirrja “European Rising Innovative City”: <https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/opportunities/topic-details/HORIZON-EIC-2025-PRIZE-2-02>